

STATUT
I SHOQERISE "NOVA ASSISTANCE" shpk

DISPOZITA TE PERGJITHESHME

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"Nova Assistance"** shpk, eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruar nga ortakët e saj bazuar ne **"Ligjin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare"**;

KREU I
THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

Sot, më 25/01/2024 ne Tirane, ne themeluesit si me poshte, bazuar ne Vendim Asambleje Nr.2, date 23.01.2024 dhe ne vullnetin e lire, krijojme shoqerine me pergjegjesi te kufizuar

Shoqeria do te emerohet **"Nova Assistance" shpk.**

- Themelues te shoqërisë jane:
- Shoqeria "Nova Construction 2012" shpk me NUIS L22404012D, me seli ne Rr. "Kajo Karafili", Pallati Mc Inerte, Tirane, ne cilesine e ortakut qe zoteron 1 kuote me pjesemarrje ne kapitalin e shoqerise prej 100 % (njeqind perqind)
- Forma e shoqerise eshte Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar

NENI 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka per objekt kryerjen e cdo veprimtarie te lejuar nga ligji dhe/ose pjesemarrjen ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar.

Me konkretisht por pa u kufizuar ne to, shoqeria **"Nova Assistance"** shpk ka per objekt:

- Shoqeri administruese e bashkepronesise ne ndertesa sipas percaktimit dhe ne perputhje me Ligjin Nr.10 112, date 09.04.2009 " Per Administrimin e Bashkepronesise ne Ndertesarat e Banimit".
- Shoqeria do te menaxhoje/administroje aktivitetin tregtar ne pasuri te paluajtshme me funksion te ndryshem si pasuri me funksion "Qender Tregtare", Parkime te hapura dhe te mbyllura publike dhe private, ambjente sherbimi si zyra dhe dyqane, apartamente banimi per qira ditore dhe afatgjate etj.

- Agjenci imobiliare, studime tregu, komisioneri dhe agjenci per te tretet, konsulente per shitblerje, qira etj te pasurive te luajtshme e te paluajtshme dhe cdo veprimtari tjetër pa kufizim qe ka lidhje me ndermjetesimin kombetar e nderkombetar ne tregun e pasurive te luajtshme e te paluajtshme.
- Sherbime konsulence ne fushen e "real estate" dhe perfaqesimi i paleve te interesuara (klienteve) per negociimin, arrijten e marreveshjeve dhe ndjekjen e procedurave ligjore per interesat pasurore te klienteve
- Aktivitet ne fushen e pasurive te paluajtshme, vleresimin e pasurive te paluajtshme, blerja, shitja, dhenia me qira e pronave te luajtshme dhe te paluajtshme si edhe ndermjetesimi per shitje, blerje apo dhenie me qira te pronave te luajtshme dhe te paluajtshme ndermjet personave fizike, personave juridike private dhe publike. Te hape dyqane, dege apo zyra po te jete e nevojshme per arrijten e qellimit te shoqerise.
- Investime ne fushen e ndertimit dhe tregtimit brenda dhe jashte vendit te pasurive te paluajtshme. Per dhenien me qira, nenqira te ambjenteve te ndryshme, si dhe cdo veprimtari tjetër e cila i sherben permbushjes se qellimit te shoqerise dhe qe nuk ndalohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi

Te kryeje cdo aktivitete tjetër qe mud te konsiderohet i dobishem ose I domosdoshem per te arritur qellimin e aktivitetit te saj.

Aplikimi dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i te gjitha lejeve dhe licencave te cilat mundesojne zhvillimin e ketij aktiviteti ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne Republiken e Shqiperise.

Shoqeria ka te drejte te ushtroje cdo lloj aktiviteti te parashikuar nga ligji ne perputhje me rregullat e dispozitat ne fuqi.

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne baze te autorizimeve dhe/ose lejeve perkatese te leshuara nga organet kompetente te fushes.

NENI 3

ADRESA E SHOQERISE

Shoqeria do te kete seline e saj ne Rr. "Kajo Karafili", Njesia Administrative Nr.10, Pallati Mc Inerte, ne Zonen Kadastrale 8380, pasuria nr.2/423-N37, Tirane

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

NENI 4

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

Kohezgjatja e Shoqerise eshte per nje periudhe te pakufizuar, periudhe e cila mund te ndryshoje me vendim te Asamblese se Ortakeve.

KREU II KAPITALI

NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 50,000,000 Leke (pesedhjetë milion).

Pjesëmarrja e themeluesit në shoqëri është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Ortakët themelues:

“Nova Construction 2012” shpk, zoteron 1 kuotë me vlerën 50,000,000 Leke (pesedhjetë milion) që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi është në para ose në natyrë, sipas vendimit të ortakëve në momentin e shlyerjes.

Shoqëria ortakë themeluese ka rënë dakort që kapitali themeltar do të depozitohet prej saj, sipas nevojës së shoqërisë, me kërkesë të administratorit, në llogarinë e saj bankare, pa qenë nevoja për nënshkrimin e akteve të tjera për miratimin e këtyre depozitimeve, brenda një afati prej 2 vitesh nga themelimi i kësaj shoqërie.

NENI 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE, DREJTUESE DHE STRUKTURE TË SHOQERISE

NENI 8

ORGANET VENDIM-MARRESE DHE DREJTUESE TË SHOQERISE

Shoqeria është e organizuar ne organet e meposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve te Shoqerise
- 2- Administratori

Asambleja e Ortakeve është organi me i larte vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te statutit:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- m) njeherazi mund te vendoset mbi lejimin ose marrjen pjese (hyrjen) ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

MËNYRA E THIRRJES SE MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 5 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se tre të katërtat ose 75% të numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e përgjithshme vendos me 75% ose me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e mëposhteme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuresë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

NENI 12

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

NENI 13

ADMINISTRIMI

1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, qe fillon me date 24.01.2024 dhe perfundon me date 23.01.2029 me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2) Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë per nje afat 5 vjecar nga data e themelimit te kesaj shoqerie.

- **Z. Biorn Shtufi**, atesia Kujtim, lindur me 30.09.2004 ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotësi te plote juridike për te vepruar, identifikuar nepermjet Leternjoftim ID me Nr. Personal K40930054F

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratori është organi drejtuesi i shoqërisë i cili ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asamblja e përgjithshme, të kryejë të gjitha veprimet bankare me çdo bankë të nivelit të dytë, pa asnjë kufizim;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare, të nënshkruajë kontrata, noteriale ose jo, apo çdo lloj akti tjetër të domosdoshëm që lidhet me aktivitetin e shoqërisë pa kufizim;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatit dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të therrase Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktiviteti i shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkuar brenda 3 muajve në vazhdim.

Nëse asamblja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 15

PERGJEGJESITË E ADMINISTRATORIT

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asamblja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

1.) administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të vecante, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprime të mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesat apo dividendet;

c) u shperndan aktivitetet e shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare duhet të parashikohet që shoqëria nuk kishte aftësi pagueuese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV
VITI FINANCIAR-EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqërise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

KREU V
PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqërise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- e) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 19

RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 20

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 21

MOSMARRËVESHJET

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

NENI 22

TE TJERA

Autorizohet Z.Enea Mitrushit me numër personal identifikimi I50823030K, për depozitim të këtij Statuti si dhe aplikimin nëpërmjet platformës e-albania për hapjen e Shoqërisë së re "Nova Assistance" shpk, me të drejtën për nënshkrimin elektronik të këtij aplikimi dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË

Shoqëria "Nova Construction 2012" shpk

Perfaqësuar nga administratori, në përputhje me Vendim Asambaleje Nr.2, dt.23.01.2024

Z. Enea Kaçi

